



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:153022

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05760090

KPPP.nr.728/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përbarimore të kreditorit “Cerrca Teknik” SH.A., me NUI: 811224617, me seli në rr. “Ahmet Gjocaj” pn, në Istog, kundër debitorit “Engineering IB” SH.A., me NUI: 811224584, me seli në rr. “Zhujë Gjoci”, në Istog, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Florim Shefqeti, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrit përbarimor P.nr.53/23 të datës 27.03.2023, të Përbaruesit Privat Shpend Ahmetaj, me seli në Pejë, jashtë seancës, me datë 30.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Engineering IB” SH.A., Urdhri Përbarimor P.nr.53/23 i datës 27.03.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Shpend Ahmetaj, SHFUQIZOHET.
- II. DETYROHET kreditori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit t’ia paguaj debitorit shumën prej 208.00 € (dyqind e tetë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Cerrca Teknik” SH.A., ka lëshuar urdhrin përbarimor P.nr.53/23 të datës 27.03.2023, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit - Faturës Nr. 20220120 të datës 20.01.2022; Faturës Nr. 20220220 të datës 20.02.2022; Faturës Nr. 20220320 të datës 20.03.2022; Faturës Nr. 20220420 të datës 20.04.2022; Faturës Nr. 20220520 të datës 20.05.2022; Faturës Nr. 20220620 të datës

20.06.2022; Faturës Nr. 20220720 të datës 20.07.2022; Faturës Nr. 20220820 të datës 20.08.2022; Faturës Nr. 20220920 të datës 20.09.2022; Faturës Nr. 20221020 të datës 20.10.2022; Faturës Nr. 20221120 të datës 20.11.2022; Faturës Nr. 20221220 të datës 20.12.2022; Faturës Nr. 20220310 të datës 10.03.2022; Faturës Nr. 20220210 të datës 10.02.2022 dhe Faturës Nr. 20220110 të datës 10.01.2022, me të cilin ka obliguar debitorin që sipas faturave së lartcekura që në afat prej 7 ditëve t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 34,620.00 €, me kamatë ligjore prej 8 %, deri në përmbarim definitiv, si dhe t'ia paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, ku ndër të tjerash ka deklaruar se kreditori ka për qëllim përfitimin e kundërligjshëm duke dëmtuar debitorin si dhe duke ju shmangur obligimeve tatimore në bazë të marrëveshjes që palët kanë pasur. Më tutje ka shtuar se në rastin konkret titulli juridik nuk është i përshtatshëm për përmbarim dhe se kërkesa e kreditorit në fatura nuk përkon me realitetin dhe si të tilla të njëjtat janë fiktive. Në lidhje me nënshkrimin e faturave ka deklaruar se janë nënshkruar nga z. G.S. por që nuk është nënshkrim origjinal i tij, sepse i njëjti nga viti 2019 nuk punon tek debitori. I ka propozuar gjykatës që të aprovet prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përmbarimor dhe të detyrohet kreditori që t'ia paguaj edhe shpenzimet e procedurës përmbarimore duke përfshirë edhe shpenzimet për përpilimin e prapësimit në shumën prej 208.00 € konform Tarifës së Odës së Avokatëve (TOAK).

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka deklaruar se me debitorin kanë pasur bashkëpunim sipas marrëveshjes së datës 01.01.2021, sipas të cilës palët si subjekte nënshkruese ishin pajtuar që të zbritet çmimi i qirasë. Më tutje ka shtuar se debitori konform nenit 368 të Ligjit Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ka pranuar obligimet që ka ndaj kreditorit me pagesën e pjesërishtme të obligimeve. Ka theksuar se pretendimet e kreditorit se faturat janë nënshkruar nga persona të paautorizuar nuk qëndrojnë, për shkak se G.S. nga fillimi i themelimit të kompanisë së kreditorit ka qenë i autorizuar që të veprojë në emër dhe për llogari të ndërmarrjes, ashtu siç ka qenë i autorizuar edhe debitori t'ia kryej disa veprime dhe se të gjitha veprimet që i ka ndërmarrë i ka realizuar në emër dhe për llogari të kreditorit dhe të njëjtat janë pranuar nga ana e palës debitore. Në fund ka shtuar se propozimin për përmbarim është dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përmbarim, për shkak se është përpiluar në formën e duhur ligjore dhe bazohet në dispozita konkrete. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi prapësimi i debitorit dhe të lejohet përmbarimi i paraqitur sipas propozimit për përmbarim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorëve të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet, për shkaket si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Faturën Nr. 20220120 të datës 20.01.2022; Faturën Nr. 20220220 të datës 20.02.2022; Faturën Nr. 20220320 të datës 20.03.2022; Faturën Nr. 20220420 të datës 20.04.2022; Faturën Nr. 20220520 të datës 20.05.2022; Faturën Nr. 20220620 të datës 20.06.2022; Faturën Nr. 20220720 të datës 20.07.2022; Faturën Nr. 20220820 të datës 20.08.2022; Faturën Nr. 20220920 të datës 20.09.2022; Faturën Nr. 20221020 të datës 20.10.2022; Faturën Nr. 20221120 të datës 20.11.2022; Faturën Nr. 20221220 të datës 20.12.2022; Faturën Nr. 20220310 të datës 10.03.2022; Faturën Nr. 20220210 të datës 10.02.2022 dhe Faturën Nr. 20220110 të datës 10.01.2022, në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se faturat e lartcekura, në bazë të së cilës është mbështetur propozimi për përmbartim dhe është lejuar urdhri përmbartimor janë bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar siç kërkohet me nenin 37 të LPP-së.

Në këtë drejtim, rezulton se propozimi për përmbartim mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri, përmban të meta ngase në propozim nuk janë treguar dokumentet origjinale apo kopje e vërtetuar mbi bazën e të cilëve është iniciuar procedura përmbartimore, ashtu siç përcaktohet edhe me dispozitën nga neni 38, paragrafi 1 të LPP-së: “Propozimi për përmbartim duhet ta

*përmbajë kërkesën për përbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”*

Sipas nenit 43, par.4 të LPP-së përcaktohet se: *“...Në lidhje me ankesën që ngreh kundërshtimin ndaj urdhrin të përbarueshmërisë së nxjerrë nga përbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përbarim nga përbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”.*

Andaj, nga të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përbarimit P.nr.53/23 i datës 27.03.2023, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përbarim nuk i janë bashkëngjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit të besueshëm dhe rrjedhimisht propozimi për përbarim përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrin.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përbarim, ndërsa organi përbarues - përbaruesi privat, nuk ka vepruar konform nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në rast se propozimi për përbarim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përbarues do të veprjë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”*, gjykata shfuqizoi urdhrin përbarimor dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të neneve 452 par.1, 453 dhe 463 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke i’ a njohur debitorit shpenzimet për përpilimin e prapësimit dhe atë në shumën prej 208.00 €.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.728/23, datë 30.05.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.